



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .12.2022

MBLEDHJA Nr. 63,
Datë 28.12.2022, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 28.12.2022, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 63 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Hec - Arsti sh.p.k., për zgjatje të afatit të derogimit miratuar me vendimin e ERE-s nr. 185, datë 13.11.2020
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, date 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, tek shoqëria “Kurum International” sh.a për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec-i “Shkopet”
5. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar
6. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar
7. Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.
8. Informacion mbi raportin vjetor të përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror nga “Albgaz” sh.a., për vitin 2021
9. Informacion lidhur me raportin e pajtueshmërisë së OST sh.a., për vitin 2021

10. Informacion mbi monitorimin e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me detyrimet dhe raportimet periodike, si dhe mbi mbikqyrjen e zbatimit të detyrave që rrjedhin për të licencuarin nga vendimi i bordit të ERE-s, nr. 201/2018, i rishikuar me vendimin nr. 217/2020, “Mbi rishikimin e planit të masave për operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike OSHEE sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike
11. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI